



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2021:225010

Datë: 07.06.2022

Numri i dokumentit: 03104626

**K.nr.1014/21**

**Gjykata Themelore në Gjilan, Departamenti i Pergjithshem – Divizioni Kundervajtes**, sipas gjyqtarit Menderes Behluli dhe zyrtares ligjore Erzë Mustafa duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj të pandehurit S. O nga fsh.... K.Gjilan, për shkak të kundërvajtjes nga neni **59 par. 1 pika 1** të Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikqyrjen e Kufirit Shtetëror, dhe në bazë të nenit 55 pika 1 dhe 2, 86, 119 dhe 124 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më **07.06.2022** mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri S. O nga babai R..., i lindur më dt. ..., jeton në fsh.D... K.Gjilan, i martuar, babai katër fëmijëve, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### **Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S**

Sepse me dt. **27.09.2021** rreth orës **17:20 min**, nga patrulla u policisë kufitare SPMK-Gjilan YEC-B.1 gjatë vëzhgimit përgjat brezit kufitar Kosovë-Serbi, në fshatin Stublinë të Gjilanit (*te lagja e Dubovëve*), ishte ndalur traktori i markes Rakovica, ngjyrë e kaltërt, me rimorkio të improvizuar, drejtuar nga i dyshuari Sami Osmani. I dyshuari ishte ndalur pasi që në Republikën e Kosovës nga republika e Serbisë kishte hyrë përmes rrugëve ilegale (rrugëve malore).

-me ç'ka ka kryer vepër kundërvajtëse të paraparë nga **neni 59** paragrafi **1.1** të Ligjit Nr.04/L-072, për Kontrollin dhe Mbikqyrjen e Kufirit Shtetëror, dhe

**D Ë N O H E T**

**ME DENIM GJOBE** në shumë prej **100 (njëqind) €**, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë në kuptim të nenit 163 pika 4 të LK-së.

Obligohet i pandehuri që kësaj gjykate t'ia paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **5 euro**, së bashku me dënimin e shqiptuar.

## A r s y e t i m

**Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare Lindje-Kaqanik-SPMK-Gjilan**, me kërkesën e vet nr.**2021-YEC-...**, të datës **27.09.2021**, ka kërkuar që ndaj të pandehurit të zhvillohet procedura kundërvajtëse të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas Ligjit.

Gjykata shqyrtoi kërkesën e parashtruar dhe konstatoi se e njëjta është e bazuar në Ligj.

Gjykata shtjelloi provat, mori në pyetje të pandehurin, ku i njëjti në deklaratën e tij thekson se është se më dt. **27.09.2021** në ora **17:20 min**, nuk i kujtohet se ditën kritike ka kaluar ilegalisht kufirin nëpër rrugë malore ndoshta ka qenë në vendin e caktuar si në fletëparaqitje dhe policia ka menduar se kinse i njëjti ka kaluar kufirin ilegalisht nga Serbia për në Kosovë me traktor duke theksuar se si do që të jetë pasi që i është shkruajtur fletëparaqitja nga policia në emër të tij kërkon ndjesë, kërkon falje, është hera e parë që i është shkruajtur një fletëparaqitje për kësi lloj kundërvajtje sepse asnjëherë nuk e

kalon kufirin ilegalisht dhe lut gjykatën që mundësisht here ti mer parasysh këto rrethana si lehtësuese dhe me rastin e vendosjes t'i shqiptoj një dënim sa më të vogël minimal.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe deklaratës së të pandehurit erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë prova të mjaftueshme, se i pandehuri është kryerës i veprës kundërvajtëse, vepër kjo e paraparë dhe sanksionuar me dispozitat e nenit **59 par.1.1** të Ligjit nr.04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikqyrjen e Kufirit Shtetëror, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, nga deklaratata e të pandehurit lidhur me veprën kundërvajtëse që i vihet në barrë, pendimin e tij, kërkim faljen, premtimin se në të ardhmen më asnjëherë nuk do të përsëritë kësi veprimi, se kjo është hera e parë që i ka ndodhur një veprim i tillë, me rastin e shqiptimit të dënimit i mori për bazë të gjitha rrethana si lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 31 të LMK-ës, peshën dhe pasojat e veprës kundërvajtëse dhe të njëjtit të pandehur ia shqiptoi këtë dënim si në dispozitiv me bindje të plotë se edhe me një dënim të këfillim do të arrihet qëllimi i dënimit që i njëjti i pandehur në të ardhmen të përmbahet dhe mos të përsërisë vepra të kësaj natyre.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 59 të LMK-ës.  
Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:225010  
Datë: 07.06.2022  
Numri i dokumentit: 03104626

**GJYKATA THEMELORE NËGJILAN**  
**DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM –DIVIZIONI KUNDERVAJTES**  
**Më dt.07.06.2022**

**Zyrtarja ligjore,**  
***Erzë Mustafa***

**Gjyqtari,**  
***Menderes Behluli***

**UDHËZIME MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë Divizionit Kundervajtes, në afat prej 8 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet përmes së këtij Divizioni Kundërvajtës.